



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0675**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Arsimi Company” SH.P.K., si dhe OE “Rahovica Commerce” SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedures lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra” me numër të prokurimit 613-25-1158-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –, “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”, më 16/09/2025, mori këtë:

### **Vendim**

- 1. Refuzohen**, si te pabazuara ankesat e OE “Arsimi Company” SH.P.K me nr. 2025/0675, e datës 21/07/2025, dhe OE “Rahovica Commerce” SH.P.K me nr.2025/0689, e datës 24/07/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra”, me numër të prokurimit 613-25-1158-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”,
- 2. Mbetet në fuqi** B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN”, për anulimin e aktivitetit të prokurimit “Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra”, me numër të prokurimit 613-25-1158-2-1-1.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 25/02/2025, “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra” me numër të prokurimit 613-25-1158-2-1-1. Ndërsa me datën 09.07.2025 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim vlera e parashikuar e kontratës: 280.000,00 €.

Me 14.07.2025, OE “Arsimi Company” SH.P.K dhe OE “Rahovica Commerce” SH.P.K me datën 14.07.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 16.07.2025, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE “Rahovica Commerce” SH.P.K dhe me datën 16.07.2025 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim te OE “Rahovica Commerce” SH.P.K.

Me 21/07/2025, OSHP ka pranuar ankesat nga OE “Arsimi Company” SH.P.K me nr. 2025/0675 dhe ankesën e OE “Rahovica Commerce” SH.P.K me nr.2025/0689 me datën 24/07/2025 lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra” me numër të prokurimit 613-25-1158-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0675/25 dhe ankesa nr. 0689/25 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Arsimi Company” SH.P.K për ankesën me nr.2025/0675 janë parashtruar si në vijim:

I.Objekti i ankesës Kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes së cilit është përjashtuar oferta jonë me arsyetimin se z. Agon Sadikaj nuk i plotëson kriteret për “5 vite përvojë pune pas diplomimit”. Ky vendim është i pabazuar ligjërisht dhe faktikisht, dhe përbën shkelje të rëndë të Ligjit për Prokurimin Publik, siç argumentohet më poshtë. II. Argumente faktike dhe ligjore 1. Përmbushja e kriterit të diplomimit dhe përvojës Kriteri i parashtruar në dosjen e tenderit ishte: “Minimumi një inxhinier ndërtimtarisë, sistemi 5-vjeçar ose (Master) – drejtimi konstruktiv, me minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit.” Ne kemi propozuar z. Agon Sadikaj, i cili:

- Ka diplomuar në Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi (drejtimi konstruktiv) në qershor 2017; • Ka përfunduar Masterin në vitin 2021 në të njëjtin drejtim;

- Ka më shumë se 6 vite përvojë pune profesionale të dokumentuar nga muaji korrik 2017, e mbështetur nga: o Pasqyra nga Trusti Pensional; o CV profesionale; o Referencë nga punëdhënësi. Pra, përvoja është pas diplomimit dhe në drejtimin kërkuar, dhe e tejkalon kërkesën për “5 vite”.

2. Keqinterpretimi i kriterit nga AK AK pretendon se përvoja duhet të fillojë vetëm pas Masterit. Ky interpretim është shtesë që nuk ekziston në dosjen e tenderit, dhe për rrjedhojë është i paligjshëm sipas nenit 59.3 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), që ndalon ndryshimin ose

shtimin e kriterëve në mënyrë kufizuese. Çdo interpretim që pretendon se përvoja duhet të fillojë vetëm pas përfundimit të nivelit Master, është i pabazuar, nuk gjen mbështetje në asnjë nen të ligjit, dhe përbën keqinterpretim të kriterit, i cili krijon pasoja të padrejta, të paligjshme dhe potencialisht diskriminuese për ne si operator ekonomik. Ligji dhe logjika juridike kërkojnë që përvoja të llogaritet pas përfundimit të studimeve që e bëjnë kandidatin të kualifikuar për rolin e kërkuar. Në këtë rast, përvoja pas diplomimit në nivelin Bachelor është e vlefshme dhe e ligjshme, pasi ky nivel i arsimit është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesën. III. Rëndësia e diplomimit në nivel Bachelor për llogaritjen e përvojës Në vendimin OSHP nr. 2024/0815, në faqen 7, Paneli Shqyrtues thekson: “Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar diplomën Bachelor dhe dokumentet për të dëshmuar përvojën pas diplomimit.” Ky citim është thelbësor, pasi tregon qartë që përvoja profesionale duhet të llogaritet që nga përfundimi i studimeve Bachelor, dhe se mungesa e këtij dokumenti përbën arsye për refuzim në rastin konkret. Në rastin tonë, nga ana tjetër, kemi dorëzuar dokumentacionin e plotë dhe të verifikueshëm, duke përfshirë diplomën Bachelor (të përfunduar në vitin 2017) dhe dëshmi të qarta të përvojës profesionale të pandërprerë dhe në fushën e kërkuar.

Si rrjedhojë, interpretimi i Autoritetit Kontraktues që përvoja duhet të fillojë vetëm pas përfundimit të studimeve Master është jo vetëm i pabazuar në dokumentacion dhe ligj, por edhe i padrejtë dhe diskriminues. Ky interpretim shkel parimet themelore të barazisë dhe konkurrencës së drejtë, të garantuara me ligj për të gjithë operatorët ekonomikë. Për më tepër, praktika ligjore dhe interpretimi i standardizuar i kriterëve të kualifikimit kërkon që përvoja të llogaritet pas arritjes së nivelit minimal të kërkuar të diplomimit, në këtë rast Bachelor, i cili është një kualifikim i njohur dhe i vlefshëm në fushën e ndërtimit. Për pasojë, kërkesa për përvojë pune pas përfundimit të Masterit paraqet një kusht të paarsyeshëm dhe artificial, që synon të përjashtojë operatorë të kualifikuar dhe të drejtë. Në dritën e mësipërme, ne kërkojmë që ky interpretim i gabuar dhe i padrejtë të rishqyrtohet me kujdes dhe të merret parasysh si argument i rëndësishëm në favor të pranimit të ofertës sonë. IV. Sistemi 3+2 = sistem 5-vjeçar (ose Master) Në Kosovë, modeli arsimor 3+2 është ekuivalent me sistemin 5-vjeçar, dhe për këtë arsye:

- Përfundimi i Bachelor + Master = 5 vite studimi formal, që përmbush kriterin “sistem 5- vjeçar ose Master”;
- Përvoja llogaritet që nga përfundimi i nivelit të parë që të kualifikon si inxhinier – pra nga Bachelor-i (2017);
- Kjo është praktikë standarde e institucioneve si MASHTI, AKK dhe Odës së Inxhinierëve. V. Shkeljet e Ligjit për Prokurimin Publik Vendimi i AK përjashton operatorin më të lirë dhe profesionalisht më të përgjegjshëm në kundërshtim me:
- Neni 7 i LPP: Parimi i barazisë, proporcionalitetit dhe konkurrencës;
- Neni 59.3 i LPP: Ndalohej interpretimi kufizues i kriterëve që nuk janë të parashtruara në dosje;
- Neni 65.1 i LPP: Vendimet për kualifikim duhet të jenë të arsyetuara dhe të bazuara vetëm në dokumentet dhe kriteret e përcaktuara. VI. Kërkesat tona para Panelit Shqyrtues 1. Të konstatohet se vendimi i AK për përjashtimin e ofertës sonë është i pabazuar në ligj dhe fakt; 2. Të urdhërohet anulimi i vendimit të AK-së dhe të kthej lenden në ri-vlerësim 3. Të rekomandohemi për kontratë ngase jemi operatori ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët. VII. Argumenti ynë në ankesë:

- Ne kemi dorëzuar diplomën Bachelor (2017) dhe dokumente të plota për përvojën (pasqyra e Trustit, CV, referenca).
- Autoriteti Kontraktues mohon përvojën deri pas Masterit, duke qenë jo vetëm në kundërshtim me kriteret (të shkruara si “ose (Master)”) por edhe me jurisprudencën e OSHP: OSHP ka pranuar se mungesa e Bachelor-it, jo mungesa e Master-it, ka qenë arsye për refuzim në vendimin 2024/0815.
- Kjo tregon se interpretimi i AK-së është i paarsyeshëm, diskriminues dhe në shkelje të parimeve të barazisë dhe proporcionalitetit, sipas Nenit 7 dhe 59 të LPP-së. VIII. Dokumente të bashkëngjitura
- Diploma Bachelor dhe Master e z. Sadikaj;
- Pasqyrë nga Trusti Pensional (nga korriku 2017);
- CV dhe referencë punëdhënësi;
- Vendimi OSHP 2024/0815 (për referencë jurisprudence).

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “Arsimi Company” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në Dispozitat e shkelura: Dispozitat e shkelura nga AK-ja Neni 1 i ligjit të prokurimit publik- qëllimi, Neni 6 i ligjit të prokurimit publik – ekonomiciteti dhe efikasiteti, Neni 7 i ligjit të prokurimit publik-barazia në trajtim/jo –diskriminim, Neni 28 i ligjit të prokurimit publik- specifikimet teknike, Neni 59 i ligjit të prokurimit publik– Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi Neni 60 i ligjit të prokurimit publik – Kriteret e dhënies, Neni 69 i ligjit të prokurimit publik – aftësia teknike dhe /ose profesionale Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve. Përmes kësaj ankese kërkojmë nga OSHP, që të merr: **V E N D I M I** APROVOHET si e bazuar Ankesa e ARSIMI COMPANY SH.P.K. **II. OBLIGOHET** Autoriteti Kontraktues-Komuna Lipjan që të kthejë lenden në ri-vlerësim dhe me rastin e ri-vlerësimit të ofertave të rekomandohemi për kontrate si operatori ekonomik I përgjegjshëm me çmimin me të lire.

Përgjigjja e AK ndaj kërkesës për rishqyrtim: “Arsimi Company” SH.P.K Përgjigjja në pretendimin e parë:

Duke u bazuar në kërkesat e AK në njoftimin për kontrate si dhe dosje të tenderit kërkesa ka qenë si në vijim;

a) Min Një inxhinier i ndërtimtarisë sistemi 5 vjeçar ose ( master) drejtimi konstruktiv min 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të caktohet si menaxher i projektit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar dhe bazuar në kërkesat e përcaktuara në dosjen e tenderit, është vlerësuar se z.Agon Sadikaj i propozuar nga operatori ekonomik për këtë pike, posedon diplomë Bachelor në sistemin 3-vjeçar dhe Master të përfunduar në vitin 2021.

Duke qenë se kërkesa e tenderit specifikon që përvoja minimale prej 5 viteve duhet të jetë pa diplomimit në sistemin 5-vjeçar ose Master, përvoja e ofruar nga viti 2017 nuk mund të merret parasysh pasi që sistemi 5 vjeçar dhe bachelor nuk janë të njëjtë.

Diploma Master ne vitin 2021 e cila përmbush kërkesën për nivelin e kërkuar te diplomimit, e qe përvoja e vlefshme në këtë rast fillon nga viti 2021 dhe deri në kohën e vlerësimit nuk i plotëson 5 vite të kërkuara sa i përket përvojës se punës pas diplomimit, e cila është kërkuar sipas kërkesave në FTD.

Prandaj, eliminimi është bërë në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik neni 59, pasi kandidati nuk ka plotësuar kushtin për përvojën profesionale pas diplomimit në nivelin e kërkuar sipas kërkesës se AK ne njoftimin për kontrata si dhe dosje te tenderit.

Pretendimi juaj është i pa bazuar.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 16.07.2025, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Rahovica Commerce” SH.P.K. për ankesën me nr.2025/0689 janë parashtruar si në vijim:

Te nderuar, Me date 09.07.2025, Autoriteti kontraktues – Komuna Lipjan, ka i publikuar B58 Njoftim për vendimin e autoritetit kontraktues, për projektin me titull: Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra Nr. Prokurimit: 613-25-1158-2-1-1 Ne si OE ankues bazuar ne dispozitat e nenit 108/A te LPP-se dhe ne afatin parapare me LPP, kemi parashtruar kërkesë për ri shqyrtim te vendimit te AK-se si rrjedhojë e kësaj bazuar ne nenin 109, te LPP-se paraqesim faktet tona si me poshtë: Pretendimi ankimor 1 Sipas letrës standarde te datës 09.07.2025, ne si kompani jemi eliminuar me arsyetimin se kemi paraqitur çmime te për pozicione specifike jashtë zakonisht te larta ! Si rrjedhojë e kësaj ne si OE ne afatin parapare me LPP-s dhe nenin 108/A, kemi paraqitur kërkesë për ri shqyrtim te vendimit – propozimit për anulimin e aktivitetit te prokurimit dhe atë me datën 14.07.2025, përderisa AK – Komuna Lipjan me vendimin e datës 16.07.2025, refuzon kërkesën tone si te pa bazuar dhe le ne fuqi vendimin për anulim te datës 09.07.2025, me arsyetimin e njëjtë si ne letër standarde. AK – Komuna Lipjan i është referuar, rregullore me nr. 002/20225, nenin 4.1, pikec c) dhe është potencuar se çmimi për m2 arrin vlerën prej 195 euro.

Kjo procedure e prokurimit është përcaktuar kontratë me çmime për njëjësi, përkatësisht vet titulli i sajë përcakton qe kemi te bëjmë me mirëmbajtje te infrastrukturës rrugore, dhe ne pozicione te paramases dhe para llogarisë kemi pozicione për rregullim dhe sanimte gropave ne rruge, mbushje me asfat dhe veprime tjera inxhinierike, për te cilat kompania e kontraktuar duhet e aktivizoi pajisje dhe makineri te rende siç janë eskavator, kamion, cilinder dhe pajisje tjera, si rrjedhoje e kësaj çmimi i ofertuar dhe i kontestuar nga AK, nuk ka kurrfarë lidhje me çmimin e larte apo jo ne harmoni me tregun.

Sa i përket çmimet për këto pozicione kjo procedurë e kontratës është me çmime për njësi dhe nuk ka sasi indikative. Ne ekzekutimin e kësaj kontrate te quajtur mirëmbajtja e infrastrukturës ne qytet dhe fshatra vet titulli i kontratës dëshmon punën e cila ka për te ekzekutuar qe është mirëmbajtje dhe sasitë te cilat realizohen ne këtë kontratë janë te vogla ne njësi matëse për m2 dhe m gjatësi nga njësia kërkuese mund te këtë kërkesa për sasi te vogla qe te intervenohet ne shume rrugica te shpërndara neper qytet dhe fshatra me sasi te vogla ne gropa te ndryshme siç janë 10, 20, 50, m2, si rrjedhoje çmimet janë reale për këto lloj sasi, pasi nuk kemi te bëjmë me riparimin e një rruge komplet me shume sasi te asfaltit, ku edhe



AK – Komuna Lipjane, për procedura paraprake si kjo ka lidhur kontrata me çmime dhe pozicione te tilla. Ne këto çmime te asfaltit ka koste mjaftë të mëdha lidhur me angazhimin e shume makinerive për prerje te asfaltit, për gërryerje te asfaltit, për shtrim te asfaltit, për ngjeshje te asfaltit dhe 5/4 ne këto vend punishte zakonisht ka vonesa te mëdha si pasoje e sasive te vogla qe kane detale te shumëta per tu ekzekutuar shtrimi asfaltit. Këtë gjë e dëshmon edhe titulli i projektit i quajtur mirëmbajtje e infrastrukturës po ashtu fakti tjetër qe e dëshmon qe kjo kontratë është për riparime me sasi te vogëla vet ne paramase ju ekeni parapare pozicionin me përshkrim. Mobilizimi i makinerisë për realizimin e punimeve- bartja dhe transporti i makineris te llogaritet në të gjithë territorin e Komunës së Lipjanit, paguhet për Një vende punishte (apo fshat) Vet përshkrimi i paramases na tregon qe do te bartet nonstop makineria ne punishte te ndryshme per shkak te sasive te vogla te asfaltimeve ku do te kete riparime te gropave prerje grryerje etj Cmimet jane normale te tregut për sasi te vogla siç i keni kërkuar ne paramase dhe duhet marre parasysh inflacionin e tregut dhe çrregullimet industriale te kohëve te fundit qe çmimet janë ne nivelet me te larta me rritjen e energjisë elektrike dhe ndryshimi ligjit për pagën minimale rritja e pagave te punëtorëve te gjitha këto janë kosto qe ndikoj direkt ne ekzekutimin e kësaj kontrate.

AK - Komuna Lipjan me rastin e eliminimit te kompanisë sonë ka shkelur ne tërësi dispozitat e nenin 61, te LPP-se ku ndaj ofertës sonë nuk ka marre kurrë far sqarimi shtese përgjatë vlerësimit te ofertave nuk ka dërguar letër standarde dhe nuk e ka njoftuar KRPP-ne ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore ne fuqi. Neni 61 i LPP-se përcaktona: 1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo[1]normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim :

(i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe

(ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni. 4. Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo[1]normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin. 5. Autoriteti kontraktues është i obliguar për të njoftuar KRPP-në brenda dy ditëve që nga data e ndonjë refuzimi nën nenin paragrafit 4. të këtij neni. Njoftimi duhet të ofrojë informacionin, shpjegimet dhe arsyet e përmendura në atë nen. Ak nuk e ka njoftuar KRPP-se dhe as kompaninë tone gjegjësisht OE ankues, si rrjedhojë e kësaj anulimi i aktivitetit te prokurimit me arsyetim te tille, nuk i plotëson kushtet ligjore te parapara me nenin 62, te LPP-se ku kjarre përcaktohen rastet kur AK përkatës mund te anuloi aktivitetin e prokurimit. 6/4 Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit 1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit. 2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit;

apo 2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve Madje anulimi i aktivitetit me si i tillë kualifikohet si shkelje e rende e ligjtë dhe e sanksionuar me nenin 97, të Rregullores me nr. 001/2022, për prokurim publik, verzioni i amandamentuar ku përcaktohet:

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen: d. Mos respektimi apo shkelja e parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP k. Anulimi i aktiviteteve të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të Ligjit të Prokurimit.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Rahovica Commerce” SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Dispozitat e shkelura të LPP nr. 04/L-042 i amandamentuar: - Neni 1 – Qëllimi - Neni 6 – Ekonomiciteti dhe efikasiteti - Neni 7 – Barazia në trajtim / jo diskriminimi Neni 25 Trajnimi i Zyrtareve të Prokurimit Neni 51 Njoftimi i Kriterëve të Përzgjedhjes Neni 59 – Ekzaminimi, krahasimi dhe vlerësimi i ofertave Neni 61 çmimet jo-normalisht të ulëta Neni 62 Përfundimi i aktivitetit të prokurimit. Rregullorja nr. 001/2022, për Prokurim Publik - Neni 4.3 i rregullores 01/2022 për Prokurim Publik - Neni 17.17 i Rregullores 01/2022 për Prokurim Publik - Neni 97 – Shkeljet e renda. Për anulim të kundërligjshëm të procedurës së prokurimit OSHP, ka inicuar procedure në KRPP, për revokim të certifikatës së prokurimit dhe KRPP, ka nxjerrë vendim për revokim të certifikatës, prandaj përmes kësaj ankese kërkojmë që OSHP, të autorizoi ekspert shqyrtues profesional, të pa aneshem, i cili i trajton pretendimet ankimore bazuar në dispozitat ligjore dhe të jete konsistente me vendimet paraprake të OSHP-se në atë mënyrë që paneli shqyrtues të nxjerrë këtë: V E N D I M I. Aprovohet, në tërësi ankesa e OE ankues Rahovica Commerce shpk si e bazuar II. Anulohet, vendim i AK-se për anulimin e aktivitetit të datës 09.07.2025, si i kundërligjshëm dhe lënda kthehet në Rivlerësim III. Lejohet, kthimi i mjeteve të deponuara në emër të ankesës. OSHP, për qeshtë tipike dhe identike, ka gjykuar ndryshe nga AK, gjegjësisht vendimet e tilla 7/4 i ka konsideruar si të kundërligjshme, madje ka ndërmarr veprime dhe ka inicuar procedure për revokimin e licencës ndaj zyrtareve përgjegjës të prokurimit dhe se në si OE disponojmë prova dhe dëshmi me të cilat do të ndërmarrim veprime tjera ligjore përkatësisht për aktivitetit të prokurimit si kjo vet AK – Komuna Lipjan ka kontraktuar kompani për pozicione identike me oferte financiare me vlere me të larte se vlera e pozicionit të kontestuar ndaj kompanisë sonë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim: “Rahovica Commerce” SH.P.K Përgjigja në pretendimin e parë:

Gjatë vlerësimit të ofertave, është konstatuar se operatori ekonomik ka paraqitur çmime të jashtëzakonshme për disa pozicione specifike, të cilat janë dukshëm më të larta sesa çmimet mesatare të tregut dhe çmimet e ofertave të tjera konkurruese në procedurë, pozicione të cilat i kemi elaboruar me poshtë.

Pretendimi juaj është se çmimet janë justifikuar për shkak të sasive të vogla dhe mobilizimit të makinerive, mirëpo këto nuk përbëjnë bazë për të tejkaluar çmimet e tregut në nivel të konsiderueshëm, veçanërisht kur konkurrenca ka ofruar çmime dukshëm më të ulëta për të njëjtat njësi.

Ne baze te rregullores se prokurimit publik, RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

4.1 Gjatë administrimit te procedurave te prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim: citoj rregulloren e lartecekur neni 4 pika “c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut”

Duke u bazuar ne çmimet tuaja ne këtë oferte ne kemi ardh ne përfundim qe për m2 çmimi juaj amn vlerën prej 195 euro qe është mbi çdo çmim te tregut duke u bazuar edhe ne ofertat tjera pjesëmarrëse për këtë AP,

Elaborim: pozicioni 1.2 Prerja profesionale sipas standardeve ne vendet e dëmtuara të rrugëve të asfaltuara, prerja me makine profesionale për prerje, rrugët e asfaltuara me trashësi sipas gjendjes ekzistuese në teren , trashësia T1=7cm dhe T2=5cm, paguhet me m = 20 €për m’ nëse behet prerja për 1 m2 dmth metër gjatësi janë 4 m’ qenjeprerje prej 1 m2ne total është = 80 €, Elaborim: pozicioni 1.3 Demolimi i asfaltit ekzistues në vendet e dëmtuar, thyerja pas prerjes, te realizohet me kompresor ose çeldq hidraulik, paguhet mem2 në çmim të llogaritet edhe ngarkimi dhe transporti deri në deponi ky pozicion është vlerësuar 30 €për m2 Elaborim: pozicioni 1.4 Grryerja e asfaltit në rrugët e dëmtuara me makin adekuate për grryerje Frezë, frezimin e shtresës së asfaltit të plasaritur Tipi -1 i rrugës përgatitjen e bazës për asfaltim , Fumizimi me material dhe lyerja me emulzion e sipërfaqes së rrugës ku kryhet intervenimi para shtruarjes së asfaltit, paguhet me m2. ky pozicion është vlerësuar 15 €per m2 Elaborim:pozicioni 1.5 Furnizimi dhe punimi i shtresës së Asfaltbetoni 011-016 mm me trashësi t=7 cm, dhe ngjeshja sipas standarde veper ket llojpozicion..Si dhe lyerja me emulzion e sipërfaqes së rrugës ku kryhet intervenimi para shtruarjes së asfaltit, Ne çmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për këtë pozicion. ky pozicion është vlerësuar 70 € për m2

Sqarim: për 1 m2 prerje, demolim, gerryerje, asfalt m2 arrin vleren 195 €

Ky çmim është vlerësuar si çmim abnormalisht i larte duke krahasuar edhe ofertat tjera pjesëmarrëse ne këtë AP. Po ashtu edhe ne çmimet e tregut qe jane ne vendin tone.

Pretendimi juaj është i pa bazuar. Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lartë, më dt; 16.07.2025, ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 22.07.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0675/2025 dhe me datën 25.07.2025 ankesën me nr. 0689/2025, ndërsa me datë 30.07.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/0675 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK-së i datës 09.07.2025.

Ndërsa për ankesën 2025/0689 me datën 30.07.2025 rekomandimi si ne vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK i datës 09.07.2025 .

Raportin e ekspertizës me nr.00675/25 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues pajtohet ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.



Raportin e ekspertizës me nr.689/25 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues pajtohet ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Arsimi Company” SH.P.K ekspertit shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0675 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Lipjanit, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës publike kornize - shërbim. Vlera e parashikuar e kontratës është: 280.000,00€. Ndërsa, kriteri i dhënies së kontratës është “Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët”.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundërt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6,7, 28, 59, 60, 69, dhe 108/A të LPP-së.

Kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, kundër kriterëve ndërsa Ekspertja shqyrtues/teknike ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.268/0205 të datës 28.04.2025. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.268/2025 të datës 02.06.2025, duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE “ AG Group” sh.p.k , kurse AK të bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit si dhe kundër eliminimit të ofertës së OE ankues. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa jep përgjigjet si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues potencon se kundërshton vendimin e AK Komuna e Lipjanit përmes të cilit është përjashtuar oferta e tyre, me arsyetimin se z. Agron Sadikaj nuk i plotëson kriteret për “5 vite përvojë pune pas diplomimit”.

Kriteri i dosjes së tenderit ishte:

a)Minimumi një inxhinier i ndërtimtarisë sistemi 5 vjeçar ose ( master) drejtimi konstruktiv min 5 vite përvojë pune pas diplomimit “

Në kemi prezantuar z. Agron Sadikaj i cili:

- Ka diplomuar në Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi (drejtimi konstruktiv) në qershor 2017;
- Ka përfunduar Masterin në vitin 2021 në të njëjtin drejtim;

- Ka më shumë se 6 vite përvojë pune profesionale të dokumentuar nga muaji korrik 2017, e mbështetur nga:

- o Pasqyra nga Trusti PENSIONAL;

- o CV profesionale;

- o Referencë nga punëdhënësi.

Pra, përvoja është pas diplomimit dhe në drejtimin kërkuar, dhe e tejkalon kërkesën për “5 vite”.

Tutje, OE ankues potencon se AK ka bërë keqinterpretim të kriterit, pasi AK pretendon se përvoja duhet të fillon vetëm pas Masterit, ky interpretim është shtesë që nuk ekziston në dosjen e tenderit dhe i paligjshëm sipas nenit 59.3 të LPP-së, që ndalon ndryshimin dhe shtimin e kriterëve në mënyrë kufizuese. Çdo interpretim që pretendon se përvoja duhet të fillojë vetëm pas përfundimit të nivelit Master, është i pabazuar, nuk gjen mbështetje në asnjë nen të ligjit, dhe përbën keqinterpretim të kriterit, i cili krijon pasoja të padrejta, të paligjshme dhe potencialisht diskriminuese për ne si operator ekonomik. Tutje OE ankues shton se ligji dhe logjika juridike kërkojnë që përvoja të llogaritet pas përfundimit të studimeve që e bëjnë kandidatin të kualifikuar për rolin e kërkuar. Në këtë rast, përvoja pas diplomimit në nivelin Bachelor është e vlefshme dhe e ligjshme, pasi ky nivel i arsimit është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesën.

OE ankues i referohet vendimit të OSHP-së me numër OSHP:2024/0815 faqe 7, i cili ka shkëputur një pjesë nga ky vendim. Po ashtu OE ankues potencon se në Kosovë, modeli arsimor 3+2 është ekuivalent me sistemin 5-vjeçar, dhe për këtë arsye:

- Përfundimi i Bachelor + Master = 5 vite studimi formal, që përmbush kriterin “sistem 5-vjeçar ose Master”;

- Përvoja llogaritet që nga përfundimi i nivelit të parë që të kualifikon si inxhinier – pra nga Bachelor-i (2017);

- Kjo është praktikë standarde e institucioneve si MASHTI, AKK dhe Odës së Inxhinierëve. Andaj vendimi i AK-së bien ndesh me nenin 7,59.3,dhe 65.1 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese sqaron se tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, AK ka kërkuar:

Kërkesa 2. Lista e stafit a) Min Një inxhinier i ndërtimtarisë sistemi 5 vjeçar ose ( master) drejtimi konstruktiv min 5 vite përvojë pune pas diplomimit, te caktohet si menaxher i projektit.

Dëshmia 2. Lista e stafit duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe e vulosur nga OE. a).Vendimi me shkrim mbi caktimin e menaxherit për këtë projekt i nënshkruar dhe vulosur nga OE b).Për stafin profesional te dëshmohen me Diplome, CV dhe licenca e gjeodetit me afat, Për te gjithë stafin kërkohen Kontratat e punës, ose parakontratat e punës me validitet dhe kohesgjatje te këtë projekti. Për diplomat e fituara jashtë Republikës se Kosovës kërkohen qe te jene te Nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Republika e Kosovës.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues sipas letrës standarde të datës 09.07.2025 është eliminuar nga AK me arsyetimin:

- Dëshmitë e ofruara për inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv nuk plotëson kërkesën e AK sa i përket përvojës së punës pas diplomimit.

- Në bazë të dëshmive Inxhinieri A.G ka të përfunduar masterin në vitin 2021, dhe si rrjedhojë nuk e plotëson kërkesën e AK.

a) Min Një inxhinier i ndërtimtarisë sistemi 5 vjeçar ose ( master) drejtimi konstruktiv min 5 vite përvojë pune pas diplomimit, te caktohet si menaxher i projektit.

Në lidhje me këtë kërkesë, ekspertja shqyrtuese sqaron OE ankues me ofertë ka bashkangjitur dokumentin me titull: 5.Punetoret.zip, 11.Agon Sadikaj Inxh. Konstruktiv.pdf

Pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve sqarojmë se OE ankues ka bashkangjitur:

- Marrëveshja mbi angazhimin për tender ;

- Diplomën e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, drejtimi Konstruktiv i e përfunduar me datën 26.06.2017, me titullin Bachelor i ndërtimtarisë –programi studimor Konstruktiv

- CV-ja dhe

- Vendimin për caktimin e menaxherit të projektit,

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK sipas letrës standarde për sqarim te tenderit, ndër të tjera ka kërkuar nga OE ankues edhe dëshmi të diplomës së masterit për inxhinierin, OE ankues ka bashkangjitur edhe diplomën e masterit për inxhinierin në fjalë, i cili i ka përfunduar studimet e masterit me datën 30.09.2021.

Ekspertja shqyrtuese konsideron se përpilimi i kërkesës “sistemi 5 vjeçar ose ( master) drejtimi konstruktiv min 5 vite, përvojë pune pas diplomimit”, autoriteti kontraktues gjatë përpilimit të kërkesës në këtë formë, ka kërkuar sistem 5 vjeçar të studimeve, nëse personi nuk posedon sistem 5 vjeçar, atëherë sistemi 3 (bachelor) + 2 (master) është ekuivalenti i sistemit 5 vjeçar. Në rastin konkret, ekspertja shqyrtuese konsideron se OE ka pasur mundësi që gjatë fazës së ofertimit të parashtroj kërkesë për ri shqyrtim dhe ti jep arsyet të cilat i ka dhënë tani në ankesë, mirëpo përderisa është pajtuar dhe ka ofertuar më këtë kriter të dosjes së tenderit, tani në këtë fazë AK dhe çdo palë tjetër duhet ti përmbahet kërkesave të vendosura. Pra, ekspertja vlerëson se kërkesa “sistemi 5 vjeçar ose ( master) drejtimi konstruktiv min 5 vite përvojë pune pas diplomimit” nënkupton që përvoja llogaritet së paku prej 5 vite nga data e diplomimit. Duke marrë për bazë formulimin e tillë të kërkesës së AK dhe dëshmive të ofruara nga OE për inxhinierin në fjalë, rezulton se i njëjti nuk plotësohen kërkesën e AK-së të cekur si më lartë. Pasi përvoja pas datës 30.09.2021 nuk mbulon kërkesën e AK-së “5 vite përvojë pune pas diplomimit”. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankues, i cili i referohet një vendim të mëparshëm të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) , ekspertja shqyrtuese sqaron se pretendimet ankimore trajtohen në bazë të dokumentacionit të aktivitetit konkret të prokurimit, përkatësisht

kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe shkresave përkatëse që kanë të bëjnë me këtë procedurë. Ekspertja nuk ka mandat dhe as autorizim për të bërë krahasime apo interpretime lidhur me aktivitetet të tjera të prokurimit, për të cilat nuk është autorizuar sepse çdo aktivitet i prokurimit është unik dhe vlerësohet mbi bazën e kriterëve të vendosura në dosjen përkatëse të tenderit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se vendimi i AK-së, bien ndesh me nenin 7,59.3, dhe 65.1 të LPP-së, ekspertja shqyrtuese sqaron se neni 59, par. 4 i LPP-së ka përcaktuar se: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit...”.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues - Komuna e Lipjanit, të mbajë në fuqi njoftimin për anulim të datës 09.07.2025, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuar.

Lidhur me pretendimet e OE “Rahovica Commerce” SH.P.K ekspert shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0689 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Komuna e Lipjanit, për këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratë publike kornize - shërbim. Vlera e parashikuar e kontratës është: 280.000,00€. Ndërsa, kriteri i dhënies së kontratës është “Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët”.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 25, 51, 59, 61, dhe 62 të LPP-së, si dhe shkelje të dispozitave të Rregullores, Nr.001/2022 për Prokurim Publik, konkretisht të nenit 4.3, 17.17 dhe 97.

Kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt i shqyrtimit në OSHP, kundër kriterëve të njoftimit për kontratë, ndërsa ekspertja shqyrtues/teknike ka nxjerr raport të ekspertizës me Nr.268/0205 të datës 28.04.2025. Po ashtu, Paneli Shqyrtues ka gjykuar me Vendimin PSH.nr.268/2025 të datës 02.06.2025, duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE “AG Group” sh.p.k, kurse AK është detyruar që të bëjë përmirësimin e dosjes së tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit dhe kundër eliminimit të ofertës së OE ankues. Ankesa e OE ankues, më saktë pretendimet ankimore janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës, ndërsa jep përgjigjet si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues potencon se sipas letrës standarde të datës 09.07.2025, është eliminuar me arsyetimin se kanë paraqitur çmime për pozicione specifike jashtë zakonisht të larta. Tutje, OE ankues shton se AK i është referuar rregullores me nr. 002/2025, nenin 4.1 pika c) dhe është potencuar se çmimi për m2 arrin vlerën prej 195 euro. Për këtë procedure është përcaktuar kontratë me çmime për njëjësi, përkatësisht vet titulli i saj përcakton që kemi të bëjmë me mirëmbajtje të infrastrukturës rrugore, dhe në pozicione të paramasës dhe parallogarisë kemi pozicione për rregullim dhe sanim të gropave në rrugë, mbushje me asfalt dhe veprime tjera inxhinjerike, për të cilat kompania e kontraktuar duhet të aktivizoj pajisje dhe makineri të rëndë, siç janë eskavator, kamion, cilindër dhe pajisje tjera, si rrjedhojë e kësaj, çmimi i ofertuar dhe i kontestuar nga AK, nuk ka kurrfarë lidhje me çmimin e lartë apo jo në harmoni me tregun. Po ashtu, sa i përket çmimet për këto pozicione, kjo procedurë e kontratës është me çmime për njësi dhe nuk ka sasi indikative. Në ekzekutimin e kësaj kontrate të quajtur mirëmbajtja e

infrastrukturës në qytet dhe fshatra, vet titulli i kontratës dëshmon punën e cila ka për të ekzekutuar që është mirëmbajtje dhe sasi të cilat realizohen në këtë kontratë janë të vogla në njësi matëse për m<sup>2</sup> dhe metër gjatësi nga njësia kërkuese mund të këtë kërkesa për sasi të vogla që të intervenohen në shumë rrugica të shpërndara nëpër qytet dhe fshatra me sasi të vogla në gropa të ndryshme, siç janë 10, 20, 50 m<sup>2</sup>, si rrjedhojë çmimet janë reale për këto lloje sasi, pasi nuk kemi të bëjmë me riparimin e një rruge komplet me shumë sasi të asfaltit, ku edhe AK - Komuna Lipjanit, për procedura paraprake si kjo ka lidhur kontrata me çmime dhe pozicione të tilla. Më tej, OE ankues shton se në këto çmime të asfaltit kanë koste mjaft të mëdha lidhur me angazhimin e shumë makinerive për prerje të asfaltit, për gërryerje të asfaltit, për shtrim të asfaltit, për ngjeshje të asfaltit dhe në këto vend punishte zakonisht ka vonesa të mëdha si pasoje e sasive të vogla që kanë detale të shumet për tu ekzekutuar shtrimi asfaltit. Çmimet janë normale të tregut për sasi të vogla siç i keni kërkuar në parametere dhe duhet marrë parasysh inflacionin e tregut dhe çrregullimet industriale të kohëve të fundit që çmimet janë në nivelet më të larta me rritjen e energjisë elektrike dhe ndryshimi i ligjit për pagën minimale rritja e pagave të punëtorëve të gjitha këto janë koste që ndikojnë direkt në ekzekutimin e kësaj kontrate. AK - Komuna Lipjan me rastin e eliminimit të kompanisë sonë ka shkelur në tërësi dispozitat e nenin 61, të LPP-se ku ndaj ofertës sonë nuk ka marrë asnjë sqarim shtese përgjatë vlerësimit të ofertave nuk ka dërguar letër standarde dhe nuk e ka njoftuar KRPP-ne ashtu siç përcaktohet me dispozita ligjore në fuqi dhe bien ndesh me nenin 61, dhe 62 të LPP-së, tutje OE ankues potencon se anulimi i aktivitetit të prokurimit pa bazë ligjore klasifikohet si shkelje e rëndë e ligjit dhe e sanksionuar me nenin 97, të Rregullores me nr. 001/2022, për Prokurim Publik.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese sqaron se OE ankues sipas letrës standarde të datës 09.07.2025 është eliminuar nga AK me arsyetimin:

Në bazë të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimi të Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik .

4.1 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

a. të luaj rol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasi, karakteristikat teknike dhe garancive;

b. për aq sa është e mundur në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet; dhe

c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut

Duke u bazuar në çmimet tuaja në këtë ofertë nësi komisioni i vlerësimit kemi ardhur në përfundim që për m<sup>2</sup> çmimi juaj arrin vlerën prej 195 euro që është mbi çmimin të tregut duke u bazuar edhe në ofertat tjera pjesëmarrëse për këtë AP.

Elaborim; pozicioni 1.2 Prerje profesionale sipas standardeve në vendet e dëmtuara të rrugëve të asfaltuara, prerja me makine profesionale për prerje, rrugët e asfaltuara me trashësi sipas gjendjes ekzistuese në teren , trashësia T1=7cm dhe T2=5cm, paguhet me m<sup>2</sup> -20 € për m<sup>2</sup>, nëse bëhet prerja për 1 m<sup>2</sup> dmth metër gjatësi janë 4m që një prerje prej 1m<sup>2</sup> në total është -80 €,

Elaborim; pozicioni 1.3 Demolimi i asfaltit ekzistues në vendet e dëmtuar, thyerja pas prerjes, të realizohet me kompresor ose çekiq hidraulik, paguhet me m<sup>2</sup> në çmim të llogaritet edhe ngarkimi



dhe transporti deri në deponi, ky pozicion është vlerësuar 30€

Elaborim; pozicioni 1.4 Gryrja e asfaltit në rrugët e dëmtuara me makinë adekuate për gërryerje Frezë, frezimin e shtresës së asfaltit të plasaritur Tipi -1 i rrugës përgatitjen e bazez për asfaltim , Furnizimi me material dhe lyerja me emulzion e sipërfaqes së rrugës ku kryhet intervenimi para shtruarjes së asfaltit, paguhet me m<sup>2</sup>, ky pozicion është vlerësuar 15€ për m<sup>2</sup>.

.Elaborim; pozicioni 1.5 Furnizimi dhe punimi i shtresës së Asfaltbetoni 011-016 mm me trashësi t=7 cm, dhe ngjeshja sipas standardeve për këtë lloj pozicion. Si dhe lyerja me emulzion e sipërfaqes së rrugës ku kryhet intervenimi para shtruarjes së asfaltit, Ne çmim te kalkulohen edhe testet marshall sipas standardeve për këtë pozicion, ky pozicion është vlerësuar 70€ për m<sup>2</sup>.

Sqarim; për 1m<sup>2</sup> prerje, demolim, gërryerje , asfalt m<sup>2</sup> arrin vlerën 195€ .

Ky çmimi është vlerësuar si çmim abnormalisht i lart duke krahasuar edhe ofertat tjera pjesëmarrëse në këtë AP, po ashtu edhe ne çminimet e tregut qe janë ne vendin tonë.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se secili autoritet kontraktues gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit ka për obligim që të zbatoj dispozitat ligjore të prokurimit. Në rastin konkret, AK ka respektuar dispozitat e nenit 4 (Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit) të Rregullores Nr.002/2024 për plotësimin dhe ndryshimi e Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik. Kjo dispozite përcakton se AK para se të inicioj një aktivitet të prokurimit ka për obligim që të hulumtoj tregun dhe të siguroj informatat e nevojshme për produktet apo shërbimet të cilat i prokuron dhe vlerësimi i çmimeve është në diskrecionin e autoritetit kontraktues, përkatësisht që të c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Hulumtimi i tillë i tregut është përcaktuar në Rregulloren e prokurimit, neni 4.1, pika C, gjë që AK i ka dhënë sqarimet e nevojshme në Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar, duke dhënë arsyetime të hollësishme për pozicionet përkatëse. Andaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, rekomandimi ynë është që Autoriteti Kontraktues - Komuna e Lipjanit , të mbajë në fuqi njoftimin për anulim të datës 09.07.2025, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pa bazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkëlqeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse në këtë rast.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertës shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik “Arsimi Company” SH.P.K duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra” me nr. të prokurimit: 613-25-1158-2-1-1. Paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në konsistencën e vendimeve paraprake me nr. 2024/0207,0209, 0213, konform vendimit të Gjykatës Themelore Prishtinë për Çështje Administrative A.nr,2276/2014, e cila vlerëson se përvoja e punës në profesion duhet të llogaritet pas datës së diplomimit, e jo të llogaritet edhe përvoja e punës para diplomimit.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertës shqyrtuese, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertës shqyrtuese. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatoreve ekonomik ankues janë të pabazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorit Ekonomik “Rahovica Commerce” SH.P.K duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – “KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN” lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mirëmbajtja e infrastrukturës në qytet dhe fshatra” me nr. të prokurimit: 613-25-1158-2-1-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së

ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN, KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - Arsimi Company SH.P.K., Rahovica Commerce SH.P.K.**
- **Arkivës së OSHP-së:**